



Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 të Rregullores nr. 03/2024 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

Titulli i pozitës së punës	Ofrues i Shërbimeve – Inkasant/e
Kohëzgjatja e emërimit	6 mujore
Paga (bruto) përfshirë kontributet e punëdhënësit	420.00 Euro
Nr. i kërkuar	3
Data e njoftimit	18.10.2024
Afati për aplikim	25.10.2024
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Departamenti	Departamenti i Koordinimit Rajonal
Divizioni	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN104 NSH Tregu
Vendi i punës	NSH "Tregu" - Tregjet e Prishtinës
Nr. i Referencës	18.10.2024 – OSH Inkasant/e

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Ofruesi i shërbimeve do të punoj ne pozitën Inkasant;
- Ofruesi i Shërbimeve angazhohet për ruajtjen dhe ngritjen e vlerës së pronës shoqërore;
- Ofruesi i shërbimeve është i obliguar të bëjë shpërndarjen e faturave me kohë në tregun përkatës, të sigurohet që fatura është pranuar me rregull dhe është nënshkruar nga qiramarrësi. Për qiramarrësit që nuk kanë pranuar faturën të mbahet evidenca dhe të lihet koment;
- Menaxhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve dhe të hyrave të tjera;
- Administrimin e faturave për secilin muaj (insertimin dhe ndarjen në regjistrator (folder));
- Kontrollimi i faturave për saktësinë e informacionit dhe përputhshmërinë me pagesat e bëra;
- Përgatitja e të gjitha dokumenteve të nevojshme për pagesat e bëra dhe ruajtja e kopjeve;
- Informimin e qiramarrësve të parregullt në pagesa për grumbullimin e borxhit dhe obligimin për pagesë.
- Të evidentohen qiramarrësit që nuk kanë paguar dhe të përgatiten faturat për fillim të procedurës përmbartimore.
- Mbanë evidence për nr. e qiramarrësve aktive në sektorin ku punonjësi është caktuar ne pozitën e Inkasantit, si dhe evidenton asetet qe nuk janë duke u shfrytëzuar;
- Kontaktimi i qiradhënësve që kanë vonesa në pagesa dhe negociimi i planeve të pagesës ose masave për mbledhjen e borxheve;
- Informimi i AL-së apo mbikëqyrësit mbi çdo problem të mundshëm që mund të ndikojë në të ardhurat e Ndërmarrjes;
- Identifikimi dhe implementimi i praktikave më të mira për inkasimin e pagesave dhe menaxhimin e borxheve;
- Sipas nevojës/kërkesës përgatit raport lidhur me gjendjen ne sektorin përkatës ku punonjësi është caktuar ne pozitën e Inkasantit;
- Zgjidhja e çdo problemi që lind gjatë procesit të inkasimit, përfshirë çështjet e pagesave të pakontrolluara ose të vonuar;



- Ofruesi i shërbimeve i caktuar në këtë pozitë i kryen punët dhe detyrat shtesë sipas kërkesës së mbikëqyrësit të drejtpërdrejt.

• 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Shkolla fillore apo e mesme.

4. Kërkesa specifike

- Përvoja në punë/aktivitet të ngjashëm si dhe ish punëtorët e kësaj NSh-je me përvojë të ngjashme do të konsiderohet përparësi.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se ka/nuk ka dosje penale në sistemin informativ të Policisë së Kosovës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit si dhe
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion.

6. Mënyra e Aplikimit

- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 25.10.2024 në ora 16:00 në emalin punesimi@pak-ks.org apo në Agjencinë Kosovare të Privatizimit - Zyra Rajonale të Prishtinës me adresë në Rr. "Dritan Hoxha", 55, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar

- Lista e kandidatëve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 31.10.2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-